Roli historik i Kongresi të Manastirit për njësimin e alfabetit të gjuhës shqipe (14-22 nëntor 1908)

Kongresi u hap në Manastir më 14 nëntor 1908 dhe i vijoi punimet deri më 22 nëntor. Në Kongres morën pjesë 32 delegatë me të drejtë vote, që përfaqësonin 26 qytete e shoqëri të ndryshme shqiptare brenda dhe jashtë atdheut, si dhe 18 delegatë të tjerë si pjesëmarrës pa të drejtë vote. Kongresi i Manastirit u shndërrua kështu në një kuvend të vërtetë mbarëshqiptar, në të cilin morën pjesë gjithsej 50 delegatë nga të gjitha anët e Shqipërisë, nga qytetet e vilajeteve të Manastirit, të Kosovës, të Janinës e të Shkodrës, si edhe nga shoqëritë shqiptare të Bukureshtit, të Sofjes, të ShBA-së, të Egjiptit, të Italisë etj.

P ë r m b a j t j a

- *Kongresi i Manastirit 14 - 22 nëntor 1908*
- *Shkolla e shkrimi shqip pas Kongresit të Manastirit dhe dhuna xhonturkę (dhjetor 1908 - gusht 1909)*
- *Kongresi i Dytë i Manastirit (2-3 prill 1910)*
- *Reakşioni xhonturk dhe qëndresa kundër tij (1909-1910)*

Kongresi Kombëtar i Elbasanit (2-8 shtator 1909

Kongresi i Manastirit 14 - 22 nëntor 1908

Përhapja e shkollave dhe e mësimit të gjuhës shqipe, si edhe zhvillimi i kulturës kombëtare në përgjithësi, shtruan në rend të ditës nevojën e caktimit të një alfabeti të vetëm. Rilindësit me të drejtë e shihnin mungesën e një alfabeti të njëjtë të gjuhës shqipe jo vetëm si një problem gjuhësor e kulturor, por edhe si një çështje politike, një shenjë ndasie, që pengonte bashkimin e shqiptarëve. Zgjidhja e saj do të ndihmonte si në lëvrimin e mëtejshëm të gjuhës e të letërsisë shqipe, ashtu edhe në konsolidimin e unitetit kombëtar dhe të bashkimit politik të popullit shqiptar.

Vendosja e një alfabeti të njëjtë të gjuhës shqipe u përgatit gjatë një epoke të tërë të Rilindjes, falë veprimtarisë krijuese në lëmin e gjuhësisë dhe të letërsisë të brezave të tërë të iluministëve shqiptarë, gjuhëtarë, shkrimtarë, poetë, publicistë etj. Një ndihmesë të vyer dhanë organet e shtypit, sidomos ato të viteve të fundit të shek. XIX dhe të fillimit të shek. XX, ku spikati në mënyrë të veçantë revista "Albania" (Bruksel-Londër, 1897-1909) e Faik Konicës. Miratimi i alfabetit (alfabetares) së Stambollit, në vitin 1879, ndonëse shënoi një hap të rëndësishëm përpara në rrugën e vendosjes së një alfabeti të njëjtë të gjuhës shqipe, nuk arriti ta zgjidhte përfundimisht këtë çështje.

Alfabeti i Stambollit u përhap vetëm në Shqipërinë e Jugut e të Mesme, ndërsa në Shqipërinë e Veriut, posaçërisht në Shkodër përdoreshin tri alfabete të tjera për shkrimin e shqipes, ai i shoqërisë "Bashkimi" (1899), i "Agimit" (i jezuitëve) dhe alfabeti i shkrimtarëve të vjetër të Veriut, që përdorej më shumë nga klerikët katolikë. Organet e shtypit shqiptar, ndonëse botoheshin të gjitha me alfabetin latin, kishin ndryshime ndërmjet tyre. Në rrethana të tilla, vendosja e një alfabeti të njëjtë të gjuhës shqipe do të arrihej jo vetëm në luftë me sunduesit e huaj osmanë, që përpiqeshin ta pengonin atë si një arritje që do të çonte në afirmimin e mëtejshëm të kombit shqiptar, por edhe duke kapërcyer frymën dhe interesat lokalë të shoqërive e të grupeve kulturore shqiptare, që ushqeheshin edhe nga dasitë krahinore të trashëguara nga e kaluara.

Ndonëse në thelb ishte një çështje kulture, njësimi i alfabetit të gjuhës shqipe paraqitej njëherazi një nga problemet më të rëndësishme politike të kohës, zgjidhja e të cilit do të varej nga zhvillimi i lëvizjes kombëtare në përgjithësi. Në të vërtetë, thirrja e kongresit për njësimin e alfabetit të gjuhës shqipe u bë e mundur vetëm në rrethanat e reja, që u krijuan për lëvizjen kulturore-kombëtare pas shpalljes së kushtetutës në vitin 1908.

Nismën për thirrjen e kongresit për njësimin e alfabetit të gjuhës shqipe e mori klubi "Bashkimi" i Manastirit, që luante rolin kryesor ndërmjet klubeve shqiptare. Drejtuesit e këtij klubi, menjëherë pas themelimit të tij, e shpallën zgjidhjen e kësaj çështjeje si detyrën më të ngutshme të lëvizjes kombëtare. Gjatë muajve gusht-

shtator, pasi kishte marrë edhe pëlqimin e klubeve e të shoqërive të tjera atdhetare, klubi i Manastirit ndërmori masat konkrete për thirrjen e kongresit kombëtar për çështjen e alfabetit. Në "Zëdhënien" që u shpërnda me këtë rast, ftoheshin të merrnin pjesë në kongres "gjithë shqiptarët, brenda dhe jashtë Shqipërisë", si edhe "çdo filolog" shqiptar. Nisma e tij u prit mirë nga atdhetarët shqiptarë dhe nga klubet e shoqëritë patriotike brenda e jashtë vendit, që u treguan të gatshme të dërgonin përfaqësuesit e tyre në këtë kongres.

Kongresi u hap në Manastir më 14 nëntor 1908 dhe i vijoi punimet deri më 22 nëntor. Në Kongres morën pjesë 32 delegatë me të drejtë vote, që përfaqësonin 26 qytete e shoqëri të ndryshme shqiptare brenda dhe jashtë atdheut, si dhe 18 delegatë të tjerë si pjesëmarrës pa të drejtë vote. Kongresi i Manastirit u shndërrua kështu në një kuvend të vërtetë mbarëshqiptar, në të cilin morën pjesë gjithsej 50 delegatë nga të gjitha anët e Shqipërisë, nga qytetet e vilajeteve të Manastirit, të Kosovës, të Janinës e të Shkodrës, si edhe nga shoqëritë shqiptare të Bukureshtit, të Sofjes, të ShBA-së, të Egjiptit, të Italisë etj.

Kongresi i Manastirit për çështjet që diskutoi e zgjidhi dhe si një nga tubimet më të gjera e më përfaqësuese nga përbërja e tij, vlerësohet me të drejtë si kuvendi më i rëndësishëm kombëtar në historinë politike e kulturore të shqiptarëve në fillim të shek. XX. Delegatë të tij ishin shkrimtarët dhe publicistët më të njohur, lëvrues të gjuhës shqipe, laikë e klerikë, si Gjergj Fishta, Nikollë Kaçori, Ndre Mjeda, Gjergj Qiriazi, Mithat Frashëri, Hilë Mosi, Mati Logoreci, Thoma Avrami, Sotir Peci, Shahin

Kolonja, Luigj Gurakuqi, Adam Shkaba; veprimtarë të lëvizjes kombëtare dhe të klubeve shqiptare, si Bajram e Çerçis Topulli, Mihal Gramenoja, Fehim Zavalani, Dhimitër Mole, Nyzhet Vrioni, Rrok Berisha, Leonidha Naço, Dhimitraq Buda, Akil Eftimi, Shefqet Frashëri, Refik Toptani, Gligor Cilka, Emin bej Shkupi, Hafiz Ibrahim efendiu (nga Shkupi), Ramiz Daci, Xhemal Beu (nga Ohri), Fahri Frashëri (nga Resna) etj. Kryetar i Kongresit u zgjodh Mithat Frashëri, ndërsa nënkryetarë Luigj Gurakuqi e Gjergj Qiriazi. Megjithatë, për një varg arsyesh të diktuara nga rrethanat e kohës, pati edhe intelektualë të shquar (si Faik Konica etj.) që nuk arritën të merrnin pjesë në punimet e këtij Kongresi.

Gjatë dy ditëve të para të Kongresit u zhvilluan mbledhje të gjera e të hapura, ku morën pjesë, përveç delegatëve, edhe intelektualë e nxënës të shkollave të Manastirit, si edhe banorë të tjerë të këtij qyteti, rreth 400 veta. Këto mbledhje u shndërruan në manifestime kombëtare, në të cilat u mbajtën fjalime patriotike për nevojën e bashkimit të të gjithë shqiptarëve, gegë e toskë, myslimanë e të krishterë, si dhe për përparimin e kombit e të kulturës së tij.

Vendin kryesor në punimet e Kongresit, duke përfshirë edhe mbledhjet e hapura, e zuri çështja e caktimit të një alfabeti të përbashkët për të gjithë shqiptarët. Gjatë diskutimeve që u bënë në ditët e para, të gjithë shfaqën mendimin se alfabeti që do të vendosej duhej të kishte si bazë atë latin. Por pikëpamjet e delegatëve më tej u ndanë, prandaj në ditën e tretë të punimeve Kongresi zgjodhi një komision prej 11 vetash, të kryesuar nga at

Gjergj Fishta, ku bënin pjesë njohësit më të mirë të gjuhës shqipe, përkrahës të alfabeteve të Stambollit, të "Bashkimit", të "Agimit", si dhe intelektualë të tjerë të shquar. Komisionit iu dhanë fuqi të plota për të vendosur për këtë çështje.

Pas shumë diskutimesh Komisioni vendosi që të mos merrej në vështrim asnjëri nga tri alfabetet e përmendura më sipër, por të krijohej një alfabet i ri mbi bazën e atij latin, duke u dhënë shkronjave latine vlera fonetike në përputhje me nevojat e gjuhës shqipe. Por Komisioni ndeshi në vështirësi për caktimin e shkronjave dyshe, që nevojiteshin për ata tinguj të shqipes, që i mungonin latinishtes (për dh, gj, nj, th etj.). Në këto rrethana, pas tri ditë diskutimesh (17-19 nëntor), anëtarët e Komisionit, sikurse thuhej në vendimin e Kongresit, "të shtyrë edhe nga disa shkaqe të përjashtme", nuk arritën të caktonin një alfabet të vetëm për gjuhën shqipe, prandaj vendosën "të kthehen prapa", duke pranuar alfabetin e Stambollit "e me të bashkë edhe një abece thjesht latine, që të përdoreshin e të mësoheshin bashkarisht në mes të shqiptarëve". Të dy alfabetet do të përdoreshin detyrimisht në shkolla.

Ky vendim, që vetë Kongresi e quajti kthim prapa, u argumentua nga Komisioni me "disa shkaqe të përjashtme" dhe pikërisht me nevojën për të shtypur me alfabetin thjesht latin libra jashtë Shqipërisë dhe për korrespondencat me jashtë. Në të vërtetë, me shkaqe të jashtme nuk kuptoheshin vetëm ato thjesht teknike, por edhe trysnia e ushtruar mbi Komisionin nga qarqet e shoqëritë e ndryshme shqiptare, që ishin për alfabetin e

Stambollit (në Shqipërinë e Jugut) dhe atë të "Bashkimit" në Gegëri e sidomos në Shkodër. Vendimi për të përdorur bashkërisht dy alfabete u mor për të mos shkaktuar përçarje në radhët e delegatëve dhe të shqiptarëve në përgjithësi. Në të njëjtën kohë ai u quajt si një zgjidhje e përkohshme për të kaluar në të ardhmen në përdorimin e një alfabeti të vetëm.
Ndonëse nuk caktoi një alfabet të vetëm, vendimi i Kongresit të Manastirit ishte një hap i rëndësishëm përpara në rrugën e zgjidhjes përfundimtare të çështjes së alfabetit të shqipes dhe ushtroi një ndikim të fuqishëm në bashkimin politik dhe përparimin e mëtejshëm kulturor të kombit shqiptar. Me këtë vendim iu dha fund kaosit që mbretëronte deri atëherë në çështjen e shkrimit të shqipes. Në vend të alfabeteve të shumta që ishin përhapur në Shqipëri e në kolonitë e mërgimit, tani do të përdoreshin vetëm dy, edhe këta bashkërisht. Përveç kësaj, duke vendosur për dy alfabete, që mbështeteshin në atë latin, Kongresi i Manastirit ripohoi edhe njëherë vendosmërinë e shqiptarëve për të mbrojtur individualitetin e tyre kombëtar, kundër orvatjeve të xhonturqve për t'u imponuar alfabetin arab dhe për t'i identifikuar ata me turqit.
Atë që nuk e çoi dot deri në fund Kongresi i Manastirit, e zgjidhi përfundimisht vetë jeta e popullit shqiptar. Alfabeti thjesht latin, duke qenë i papërzier e më homogjen nga karakteri i shkronjave, më i lehtë e më praktik për shtyp, u përhap gjithnjë e më shumë dhe nga fundi i Luftës së Parë Botërore u bë tashmë alfabeti i përbashkët e i vetëm për gjithë shqiptarët, alfabeti i

sotëm i gjuhës shqipe. Megjithëse çështja e njësimit të alfabetit zuri vendin kryesor në punimet e Kongresit të Manastirit, vetë Kongresi nuk ishte një mbledhje thjesht gjuhësore, por edhe një manifestim politik. Krahas tubimeve të hapura, u organizuan edhe mbledhje të fshehta kushtuar çështjeve politike të ditës. Objekti kryesor i diskutimeve në këto mbledhje ishin marrëdhëniet e shqiptarëve me turqit, lufta për të drejtat kombëtare të popullit shqiptar, për zhvillimin kulturor dhe ekonomik të vendit, si edhe marrëdhëniet me shtetet evropiane. Përfundimet e këtyre diskutimeve dhe vendimet që u morën në këto mbledhje, u përfshinë në programin kombëtar prej 18 pikash që iu dha deputetit të Korçës, Shahin Kolonjës, për ta paraqitur në parlament në emër të shqiptarëve. Ky program është një nga dokumentet më të rëndësishme të Kongresit të Manastirit, në të cilin u pasqyruan aspiratat e shqiptarëve për autonominë territoriale-administrative të Shqipërisë.

Vendin kryesor në program e zinin kërkesat politike për "njohjen zyrtare të kombësisë shqiptare dhe të gjuhës shqipe". Në lidhje të ngushtë me këtë kërkohej emërimi i nëpunësve shqiptarë në të katër vilajetet, zgjedhja e të gjitha organeve lokale, zgjerimi i kompetencave të tyre dhe kryerja e shërbimit ushtarak nga dy deri në dy vjet e gjysmë në Shqipëri, nën drejtimin e oficerëve shqiptarë të dalë nga shkollat ushtarake që do të ngriheshin në vend.

Pjesë përbërëse e kërkesës për njohjen e kombësisë shqiptare dhe e të drejtave të saj, ishte edhe themelimi i shkollës së pavarur shqipe, që do të arrihej duke i kthyer të gjitha shkollat shtetërore turke në Shqipëri, ato fillore,

qytetëse e të mesme, në shkolla kombëtare dhe duke vendosur gjuhën amtare shqipe "si gjuhë mësimi në të gjitha këto shkolla shtetërore", ndërsa turqishtja do të mësohej si lëndë e veçantë, duke filluar nga viti katërt i shkollës fillore. Të lidhura ngushtë me këtë ishin edhe masat që parashikohej të merreshin për kthimin e shkollave në gjuhën greke, që funksiononin për shqiptarët e krishterë, në shkolla kombëtare, me gjuhën shqipe si gjuhë mësimi, duke i hequr ato nga administrimi i klerit dhe duke i shpallur shkolla shtetërore. Këto shkolla do të mbaheshin me të ardhurat nga pasuritë e kishave, të cilat duhej të administroheshin nga shteti dhe me të ardhurat e buxhetit të shtetit osman. Për t'u prerë rrugën ndërhyrjeve të Austrisë, të Italisë e të Greqisë në Shqipëri, kërkohej që klerikët katolikë e ortodoksë të paguheshin nga shteti turk. Me këto masa do të kufizohej ndikimi i propagandave të huaja shkollore e kishtare në Shqipëri, sidomos i asaj greke.

Një nga kërkesat më të rëndësishme në fushën e arsimit ishte ajo për themelimin e një universiteti shqiptar, që kishte qenë aspiratë e hershme e rilindësve. Për përgatitjen e profesorëve për këtë universitet do të dërgoheshin çdo vit, me bursa të shtetit, të rinj që do të mësonin në shkollat e larta të Evropës dhe të ShBA-së. Po kështu kërkohej të themelohej një muze arkeologjik kombëtar në një nga qytetet e Shqipërisë.

Programi përmbante gjithashtu një varg masash, që kishin për qëllim zhvillimin ekonomik të vendit, për të cilin ishte interesuar borgjezia shqiptare. Të tilla ishin masat për hapjen dhe shfrytëzimin e minierave, për

ndërtimin e hekurudhave nga sipërmarrës shqiptarë, për ngritjen e ekonomive të mëdha bujqësore në Myzeqe etj. Në pjesën ekonomike përfshihej edhe kërkesa për kufizimin e depërtimit të kapitalit të huaj në ekonominë shqiptare, që kishte për qëllim të ndalonte ekspansionin ekonomik të shteteve të huaja dhe në mënyrë të veçantë t'u jepte mundësi borgjezisë shqiptare e kapitalit vendas të shtinte në dorë tregun dhe ekonominë e Shqipërisë.
Programi politik, i miratuar në Kongresin e Manastirit, megjithëse nuk përmbante kërkesa të domosdoshme për organizimin e një shteti autonom, si veçimi i territoreve shqiptare dhe forma e qeverisjes së tyre, ai pati rëndësi të veçantë, sepse i përmbysi shpresat e tyrqve të rinj dhe të bashkëpunëtorëve të tyre shqiptarë për ta kufizuar Kongresin vetëm me çështjet e alfabetit, për ta mbajtur larg problemeve politike e luftës kundër regjimit xhonturk. Miratimi i tij dëshmonte gjithashtu se Lëvizja Kombëtare Shqiptare edhe pas shpalljes së kushtetutës kishte ruajtur karakterin e saj politik e të pavarur dhe kishte si objektiv themelor realizimin e autonomisë së Shqipërisë.
Kongresi i Manastirit shënoi gjithashtu një hap të rëndësishëm në ngritjen e shkallës së organizimit të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare. Vetë thirrja e tij si një forum mbarëkombëtar, vendimet që mori për çështje të tilla që i takonin gjithë kombit dhe, në mënyrë të veçantë, njohja faktike e klubit të Manastirit si klub qendror, me të cilin do të mbanin lidhje gjithë klubet e tjera, dëshmojnë për vendosjen e një bashkërendimi të veprimtarisë organizative e politike-kulturore të klubeve dhe të

shoqërive shqiptare, nën drejtimin e klubit "Bashkimi" të Manastirit. Jo rastësisht konsujt e huaj e trajtonin këtë masë si një përpjekje që do të krijonte njëlloj federate të klubeve shqiptare.
Vendimi për t'i dhënë klubit "Bashkimi" të Manastirit, që qëndronte në krye të luftës për të drejtat kombëtare të shqiptarëve, atributet e një klubi qendror, u arrit pas kundërshtimit të përpjekjeve të krahut të moderuar të lëvizjes kombëtare për t'u imponuar klubeve e shoqërive shqiptare udhëheqjen politike dhe organizative të klubit të Stambollit, drejtuesit e të cilit, përgjithësisht, njiheshin si përkrahës të xhonturqve.
Kongresi i Manastirit dhe vendimet e tij përbëjnë një nga ngjarjet më të rëndësishme në historinë e re të popullit shqiptar. Për herë të parë pas kuvendeve, që u mbajtën në periudhën e Lidhjes së Prizrenit (1878-1881) dhe të Lidhjes së Pejës (1899-1900), u mblodhën në këtë Kongres përfaqësues nga të gjitha krahinat e Shqipërisë dhe u morën vendime të rëndësishme për çështjen e alfabetit e për ato politike, që ndihmuan për ngritjen në një shkallë më të lartë të kulturës e të arsimit shqiptar, si edhe për bashkimin e tij të mëtejshëm në luftën për çlirimin kombëtar.

Shkolla e shkrimi shqip pas Kongresit të Manastirit dhe dhuna xhonturke (dhjetor 1908 - gusht 1909)

Të mbështetur në vendimet e Kongresit të Manastirit, atdhetarët shqiptarë hapën shkolla të reja shqipe dhe i shtuan përpjekjet për të përhapur shkrimin shqip në të katër anët e vendit. Në janar të vitit 1909 klubi i Elbasanit mblodhi të holla të mjaftueshme për të mbajtur me mjetet e tij 4 shkolla shqipe, një në qytet me 100 nxënës dhe tri në fshatra me nga 60 nxënës secila. Klubi kishte caktuar gjithashtu 3 mësues shëtitës në krahinën e Shpatit, të cilët u mësonin gjuhën shqipe fëmijëve e banorëve të rritur të 10 fshatrave. Përveç këtyre, që nga fundi i vitit 1908 në Shpat funksiononin 4 shkolla shqipe, ku mësonin fëmijët e 19 fshatrave.

Në janar-shkurt të vitit 1909 u ngrit një shkollë shqipe në Glinë të Leskovikut, një në Pogradec, dy shkolla shqipe në katundet Kakos e Selenicë të Frashërit (në të cilat mësonin edhe fëmijët e katundeve përreth), një shkollë shqipe në katundin Cakran të Fierit dhe një tjetër në Negovan. Në shkurt të vitit 1909 filloi të funksiononte shkolla shqipe e Kumanovës, që u hap nga klubi shqiptar i këtij qyteti. Në fillim të vitit 1909, pas një lufte të ashpër me oficerët xhonturq, u arrit të çelen shkolla shqipe në qytetin e Ohrit. Në mars të vitit 1909 në Korçë, përveç dy shkollave të hapura menjëherë pas shpalljes së kushtetutës, u çel edhe një shkollë tjetër e pavarur për djem, kurse në verën e atij viti u çel një shkollë shqipe në fshatin Libohovë.

Me përpjekjet e klubeve vijoi të futet mësimi i gjuhës shqipe në shkollat shtetërore turke dhe të huaja. Në dhjetor të vitit 1908 mësimi i gjuhës shqipe ishte futur si lëndë e detyrueshme në të katër shkollat fillore turke të

Elbasanit, në atë gjysmë të mesme (qytetëse), si edhe në shkollën e komunitetit ortodoks. Pranë kësaj shkolle ishte ngritur edhe një kurs nate për mësimin e shqipes, që ndiqej nga 60 djem. Pas kësaj qeveria greke i preu kësaj shkolle subvencionimin.

Në fillim të vitit 1909 klubet shqiptare arritën të fusnin mësimin e gjuhës shqipe në shkollat fillore turke të Gjirokastrës, të Frashërit, të Përmetit, të Tepelenës, të Beratit, të Peqinit, të disa fshatrave të Mallakastrës etj., ndërsa klubi i Vlorës e shndërroi shkollën fillore turke të këtij qyteti në shkollë shqipe. Mësimi i shqipes u fut gjithashtu në shkollat turke të fshatrave Qesarakë, Novoselë e Selenicë e Kolonjës dhe në shkollën greke të Fierit.

Në pranverën e vitit 1909, falë përpjekjeve të klubeve e të mësuesve atdhetarë, gjuha shqipe mësohej edhe në shkollat qytetëse (ruzhdie) turke të Vlorës, të Përmetit, të Mitrovicës, të Beratit si dhe në disa gjimnaze (idadie) të vendit, si në atë të Manastirit, të Gjirokastrës, të Beratit, të Korçës, të Janinës, të Durrësit, të Shkupit etj. Në mjaft qytete të Shqipërisë u kërkua që gjuha shqipe të përdorej edhe në gjykata e në predikimet fetare të kishës ortodokse. Në fundin e shkurtit të vitit 1909 klubi i Korçës, së bashku me përfaqësuesit e popullsisë ortodokse të këtij qyteti, vendosi që predikimi në kishat ortodokse të bëhej në gjuhën shqipe. Ky vendim iu njoftua edhe peshkopit të Korçës, Patrikanës së Stambollit dhe valiut të Manastirit. Ndërkaq, atdhetarët korçarë, me nismën e tyre, filluan të futnin gradualisht

gjuhën shqipe në kishat e qytetit. Në kishën e Negovanit predikimi filloi të bëhej gjithashtu në shqip.
Edhe përfaqësuesit e popullsisë katolike e myslimane të Kurbinit, në mbledhjen që mbajtën në gusht të vitit 1909, kërkuan nga qeveria turke që të hapte shkolla fillore shqipe në fshatrat e kësaj krahine. Klubi i Elbasanit, për të shmangur pengesat që xhonturqit u nxirrnin shkollave shqipe, u propozoi më 31 dhjetor gjithë klubeve shqiptare që t'i përcillnin parlamentit turk e deputetëve shqiptarë kërkesën për njohjen zyrtare të kombësisë shqiptare, plotësimi i së cilës do t'u siguronte shqiptarëve të drejtat kombëtare në lëmin e kulturës dhe të arsimit. Por kjo kërkesë nuk u miratua nga qeveria turke. Shkolla shqipe qysh në periudhën e parë pas revolucionit u ndesh me përpjekjet e xhonturqve për të penguar përhapjen e saj. Prandaj edhe përkrahja që shqiptarët u dhanë xhonturqve për shtypjen e kundërrevolucionit të prillit të vitit 1909, ishte akti i fundit i bashkëpunimit me ta. Pasi forcuan pozitat në Stamboll, xhonturqit kaluan në përdorimin e masave shtypëse ndaj lëvizjes kulturore të popujve të shtypur në përgjithësi dhe të shqiptarëve në veçanti.
Lëvizja për arsimin e kulturën kombëtare shqiptare u gjend shumë shpejt përballë goditjeve të Komitetit "Bashkim e Përparim", i cili, meqë paraqitej si mbrojtës i kushtetutës, vepronte më shpesh në mënyrë të fshehtë sesa të hapur. Një nga mjetet kryesore që xhonturqit përdorën për të ndaluar këtë lëvizje, për t'i përçarë shqiptarët sipas dasisë fetare dhe për të penguar ngritjen e ndërgjegjes kombëtare, ishte propaganda e shkrimit të

gjuhës shqipe me alfabetin arab, që filloi menjëherë pas Kongresit të Manastirit. Në shërbim të kësaj propagande u vunë disa nga klerikët konservatorë myslimanë dhe elementë të tjerë fanatikë e turkomanë, të cilët, duke shfrytëzuar ndjenjat fetare të popullsisë myslimane shqiptare, u përpoqën të formonin tek ajo bindjen se shkronjat latine janë të të pafeve (të kaurëve), se binin ndesh me fenë islame dhe se shqipja mund të shkruhej vetëm me alfabetin turko-arab, që ishte i shenjtë, sepse me të ishte shkruar Kurani. Në fillim të vitit 1909 u formua në Stamboll "Shoqëria për mësimin dhe për shkrimin e gjuhës shqipe me shkronjat turqishte", e përbërë kryesisht nga ulematë (klerikët e lartë) myslimanë, që shpërndante thirrje dhe abetare shqipe me alfabetin arab. Një abetare e tillë u përhap në viset e ndryshme të Shqipërisë në muajin janar të atij viti.

Kjo fushatë u shoqërua me orvatjet, që xhonturqit bënë për të provokuar mitingje të elementëve fanatikë e turkomanë kundër përdorimit të alfabetit latin, siç ndodhi në fillim të shkurtit në Manastir, në Dibër, në Follorinë e në Përlepë. Konsulli francez në Manastir, Pisho (Pichon), në informacionin e tij (të 16 shkurtit 1909), shkruante se "në këto tubime, të provokuara në mënyrë të fshehtë nga vetë autoritetet turke, nuk arritën të grumbullohen veçse hoxhallarët dhe turqit fanatikë, ndërsa shqiptarët, thuajse në mënyrë të përgjithshme nuk pranuan të duken atje". Jo rastësisht këto mitingje u mbajtën në xhami. Po kështu, ulematë dhe disa nga hoxhallarët e Shkodrës, të nxitur nga Komiteti "Bashkim e Përparim" i këtij qyteti, duke përfituar nga fanatizmi i

pjesës myslimane të popullsisë, zhvilluan në pranverën e vitit 1909 një agjitacion të fuqishëm për përdorimin e alfabetit arab në shkrimin e shqipes.
Ministria e Arsimit e Turqisë që në fund të vitit 1908 urdhëroi që në shkollat e vilajetit të Kosovës shqipja të mësohej me shkronjat arabe. Një urdhër i tillë iu dha në shkurt të vitit 1909 edhe prefekturës së Elbasanit. Po kështu vepruan autoritetet turke dhe komitetet xhonturke në qytetet e tjera të vendit, në Janinë, në Filat etj. Atdhetarët shqiptarë të këtyre trevave u vunë para një trysnie të dyfishtë, të shovinistëve grekë dhe të xhonturqve, që vepronin të bashkuar në luftën kundër shkollës dhe kundër shkrimit shqip. Në të njëjtën kohë komitetet xhonturke përkrahnin në ato ditë propagandën asimiluese panhelenike që disa profesorë grekë dhe Shoqëria "Etniki Heteria" ("Shoqëria Kombëtare") zhvillonin në atë kohë në viset shqiptare të vilajetit të Janinës.
Për të fshehur veprimtarinë e tij armiqësore kundër kulturës shqiptare, Komiteti Qendror "Bashkim e Përparim" në mars të vitit 1909 u kumtoi klubeve shqiptare se "do të qëndronte asnjanës dhe nuk do të ndërhynte në çështjen e zgjedhjes së alfabetit të gjuhës shqipe". Klubet e quajtën këtë deklaratë një përpjekje të re për të mashtruar shqiptarët dhe morën masa për të mbrojtur liritë kushtetuese e për t'i bërë ballë reaksionit xhonturk. Në protestën që klubi "Bashkimi" i Manastirit i dërgoi Komitetit Qendror "Bashkim e Përparim" në javën e fundit të marsit, i shkruante se, duke luftuar alfabetin shqip ky komitet bie ndesh me kushtetutën

turke, e cila ua garanton gjithë popujve të Perandorisë të drejtën e mësimit dhe të shkrimit të gjuhës amtare. Në letërkëmbimin e tij të marsit të vitit 1909 me klubet e Filatit, të Korçës etj., klubi "Bashkimi" i Manastirit i quante këto veprime të xhonturqve dhe të turkomanëve shqiptarë për t'u imponuar shqiptarëve alfabetin arab, si veprime armiqësore kundër kombit shqiptar. Ai udhëzonte në ato ditë klubet e tjera kombëtare që "kundër këtyre tradhtarëve të mos vepronin vetëm me penë, por edhe me armë".

Komiteti "Bashkim e Përparim" u orvat të zhdukte klubet shqiptare dhe atdhetarët më të njohur, që drejtonin luftën kundër reaksionit xhonturk. Në maj të vitit 1909 xhonturqit, pasi arrestuan disa nga veprimtarët e klubit "Labëria" të Vlorës dhe i detyruan të tjerët të arratiseshin jashtë Shqipërisë, e likuiduan këtë klub, që ishte një nga më të rëndësishmit në Shqipërinë e Jugut. Po në atë kohë mbyllën edhe klubin e Ohrit, kryesia e të cilit u çua e lidhur me pranga në Manastir e pastaj në Stamboll.

Në fundin e majit të vitit 1909 vetëm në Ohër, në Pogradec e në Strugë u arrestuan 17 veta, përkrahës të shkollës dhe të shkrimit shqip, që u akuzuan për propagandë reaksionare kundër regjimit kushtetues. Midis të arrestuarve ishin edhe Hamdi Ohri, një nga udhëheqësit më në zë të lëvizjes kombëtare në këtë trevë, që kishte kaluar vite të tëra në burgjet e sulltan Abdyl Hamitit, Xhemaledin Beu, kryetar i klubit të Ohrit dhe Mehmet Beu, sekretar i klubit, intelektual dhe përkrahës i shkollës shqipe. Klubet shqiptare protestuan kundër këtij

veprimi të dhunshëm, derisa i detyruan xhonturqit t'i shpallnin të pafajshëm dhe t'i lironin këta atdhetarë.
Ditë të vështira kaloi në verën e vitit 1909 lëvizja kulturore kombëtare në Tiranë. Më 23 korrik, në përvjetorin e shpalljes së kushtetutës, u zhvillua në Tiranë ceremonia e hapjes së klubit të këtij qyteti. Ishte paraparë gjithashtu që më 24 të këtij muaji të çelej një shkollë shqipe e mbrëmjes për të rriturit dhe të fillonte në mënyrë të organizuar mësimi i gjuhës shqipe në të gjitha shkollat shtetërore turke të Tiranës. Por pikërisht në këtë ditë, me nxitjen e komiteteve xhonturke dhe të klubeve të oficerëve të lidhur me ta, nxënësit sulmuan e goditën në të gjitha shkollat mësuesit atdhetarë, sapo këta u njoftuan se nga ai çast do të fillonin mësimin e gjuhës shqipe. Më 27 korrik, po me shtytjen e klubeve të oficerëve, hynë në Tiranë më shumë se 200 fshatarë të armatosur, që demonstruan në rrugët e qytetit dhe para klubit të oficerëve, duke kërkuar mbylljen e klubit shqiptar dhe arrestimin e 64 anëtarëve të tij.
Veprimtarë të tillë të lëvizjes kombëtare në Tiranë, si Refik Toptani e bashkëpunëtorët e tij, ose klerikët atdhetarë Hafiz Ibrahim Dalliu, Beqir Luga etj., u sulmuan drejtpërdrejt dhe u fyen publikisht. Me këto veprime të xhonturqve e të turmave fanatike të këtij rrethi u mbyll klubi kombëtar i Tiranës dhe dështoi orvatja e atdhetarëve tiranas për të futur gjuhën shqipe në shkollat e këtij qyteti. E njëjta gjendje u krijua edhe në Durrës, në kryeqendrën e prefekturës, ku atdhetarët shqiptarë nuk guxonin të hapnin klube e shkolla shqipe, si edhe në nënprefekturën e Kavajës, ku përpjekjet për

hapjen e shkollës shqipe e të mësimit shqip ndeshën në kundërshtimin e reaksionit xhonturk dhe të klerikëve fanatikë myslimanë.
Aktet e dhunshme të xhonturqve, sidomos ngjarjet e Tiranës, e bënë gazetën "Dielli" të shkruante në atë kohë se "sot punërat në Shqipëri janë më keq se në kohërat e Abdyl Hamitit. Sot gjuha shqipe ndiqet më tepër se kurrë ndonjëherë" ("Çështja e Tiranës", 16 shtator 1909). Ishin këto veprime arbitrare të administratës osmane, që i bënë konsujt e huaj, bashkëkohës të këtyre ngjarjeve, të arrinin në përfundimin se turqit e rinj "po mbajnë qëndrim armiqësor ndaj nacionalizmit shqiptar", se "duke zbatuar traditat hamitiane dhe në kundërshtim me premtimet e tyre solemne, ata po persekutojnë çdo shfaqje të ndjenjave kombëtare shqiptare", se në Turqi po shkohej drejt një diktature ushtarake dhe se kishte rrezik që kushtetuta të kthehej në një iluzion. Politika turqizuese kundër shkollave e shkrimit shqip dhe konflikti i armatosur me shqiptarët, i nxitur nga administrata ushtarake osmane, zbuloi para popullit shqiptar thelbin reaksionar të regjimit xhonturk.

Kongresi i Dytë i Manastirit (2-3 prill 1910)

Në këtë gjendje të acaruar të marrëdhënieve shqiptaro-turke, kur konflikti me xhonturqit për çështjet e kulturës shqiptare kishte arritur kulmin e tij, atdhetarët shqiptarë mblodhën një kuvend tjetër kombëtar, Kongresin e Dytë

të Manastirit. Ky tubim u thirr me nismën e klubit "Bashkimi" të Manastirit dhe i zhvilloi punimet nga 2-3 prill të vitit 1910.
Në Kongres morën pjesë 20 delegatë, që përfaqësonin 34 klube e shoqëri të vilajeteve të Shkodrës, të Kosovës, të Manastirit e të Janinës, si edhe klubet shqiptare të Stambollit, të Selanikut e të qendrave të tjera. Kongresit i erdhën telegrame përshëndetjeje nga anë të ndryshme të Shqipërisë dhe nga shoqëritë atdhetare të mërgimit.
Ndryshe nga kongreset e mëparshme kombëtare, në këtë kuvend pati një numër mjaft të madh delegatësh nga qytetet e vilajeteve të Kosovës dhe të Manastirit, nga Peja, Gjakova, Gjilani, Mitrovica, Vuçiterna, Shkupi, Tetova, Dibra, Struga, Ohri etj. Midis delegatëve ishin Dervish Hima, Fehim Zavalani, Petro Nini Luarasi, Hysni Curri, Ferit Ypi, Bedri Pejani, Qamil Shkupi, Gjergj Qiriazi, Bejtullah Gjilani, Themistokli Germenji, Tefik Panariti, Hajdar Blloshmi, Abdullah Efendiu (nga Struga), Qazim Iliaz Dibra, Rexhep Mitrovica, Xhafer Kolonja etj. Kryetar i Kongresit u zgjodh Bedri Pejani, ndërsa sekretarë Ferit Ypi dhe Petro Nini Luarasi.
Sikurse dëshmon "Zëdhënia" që klubi "Bashkimi" i Manastirit shpërndau me këtë rast, qëllimi i këtij Kongresi ishte të diskutonte çështjet që kishin të bënin me mbrojtjen e shkollës, të shkrimit e të kulturës kombëtare kundër reaksionit xhonturk dhe kundër politikës asimiluese të xhonturqve. Kongresi do të merrte masa të mëtejshme për zgjerimin e rrjetit të shkollave shqipe dhe për zhvillimin e kulturës shqiptare në tërësi.

Kongresi i Dytë i Manastirit ishte një manifestim politik e kombëtar shqiptar. Si në fjalimet e delegatëve, ashtu edhe në vendimet e Kongresit u shpreh protesta kundër përndjekjeve që po u bëheshin shkollës e alfabetit shqip nga Komiteti Qendror "Bashkim e Përparim" dhe nga qeveria turke.

Dervish Hima, që mbajti edhe fjalën e hapjes në Kongres, foli "për nevojat e zhvillimit të arsimit, të përhapjes së diturisë dhe të përparimit të kombit shqiptar". Ai dhe delegatët e tjerë, si Ferit Ypi, Tefik Panariti etj., kritikuan Komitetin Qendror "Bashkim e Përparim", i cili, në kundërshtim me premtimet që u kishte bërë shqiptarëve, po u mohonte të drejtën e arsimit kombëtar dhe të përdorimit të lirë të gjuhës shqipe, ndërhynte egërsisht në çështjen e alfabetit të gjuhës shqipe, që ishte një e drejtë e natyrshme e njerëzore si për çdo popull. Ky qëndrim i xhonturqve u cilësua nga delegatët si një përpjekje për të përçarë shqiptarët sipas dasive fetare, për të osmanizuar myslimanët shqiptarë dhe për të penguar përparimin kulturor dhe emancipimin politik të kombit shqiptar. "Na kanë shpallur luftë në fushën e shkronjave", theksoi Dervish Hima në Kongres, prandaj "ne që jemi mbledhur këtu, bashkë me gjithë atdhetarët shqiptarë, do t'i mbrojmë me çdo mjet shkronjat tona kombëtare…".

Kongresi tërhoqi vëmendjen e gjithë atdhetarëve shqiptarë për rrezikun e shkombëtarizimit dhe të aneksimit të territoreve të Shqipërisë nga shtetet fqinje, nga Serbia, Greqia e Bullgaria. Serbia, u tha në Kongres, duke ndjekur një politikë shoviniste, synon të pushtojë

Kosovën, të cilën e ka pagëzuar me emrin "Stara Serbia", ndërsa qarqet politike të Greqisë po përpiqen me të gjitha mjetet, duke përdorur klerikët ortodoksë konservatorë e progrekë, shkollat e mësuesit grekomanë, të asimilojnë shqiptarët e krishterë dhe të aneksojnë territoret e Shqipërisë së Jugut. Petro N. Luarasi theksoi në fjalën e tij se këta klerikë fanatikë e grekomanë, të nxitur nga Greqia, mallkojnë e shkishërojnë banorët e fshatrave Progër, Negovan e Bellkamen sepse çojnë fëmijët në shkollat shqipe, ndërsa bandat e andartëve grekë, të paguar nga Athina, vrasin atdhetarët më të dalluar që përhapin mësimin e shkrimin shqip. Gjatë 5 vjetëve të fundit ishin vrarë në Negovan nga bandat greke 45 shqiptarë. Për të paralizuar këtë veprimtari Petro Nini Luarasi, përveç të tjerave, i propozoi Kongresit që të kërkonte që kisha shqiptare të ndahej nga Patrikana greke.

Aktet kryesore të Kongresit të Dytë të Manastirit ishin Programi prej 10 pikash dhe një Promemorje prej 4 pikash, që iu dërgua qeverisë turke. Në këto dokumente parashikoheshin masa të rëndësishme për zhvillimin e arsimit kombëtar, për mbrojtjen e alfabetit të shqipes, për botimin e librave dhe të teksteve shkollore shqipe. Për këtë qëllim do të ngrihej pranë klubit qendror një komision arsimor-kulturor, që në program quhej Akademi, i cili do të merrej me botimin e teksteve shkollore, të veprave letrare dhe të një fjalori shqip-turqisht e anasjelltas. Parashikohej të hapej në Shkup një shkollë normale me konvikt, e ngjashme me atë të Elbasanit, dhe të themelohej këtu një gazetë e re në shqip

dhe në turqisht, me anën e së cilës do të informoheshin shqiptarët dhe opinioni publik evropian për ngjarjet e rëndësishme që po zhvilloheshin në këtë vilajet. Kongresi ngarkonte klubet dhe gjithë atdhetarët shqiptarë që të punonin për zgjerimin e mëtejshëm të rrjetit të shkollave shqipe, për sigurimin e lokaleve shkollore, të mësuesve dhe të mjeteve të nevojshme financiare.

Në Promemorjen prej katër pikash, që iu dërgua Portës së Lartë, parashtroheshin këto kërkesa: të jepej liri e plotë për mësimin e gjuhës shqipe, në përputhje me të drejtat kushtetuese; të mënjanoheshin të gjitha pengesat që nxirrnin autoritetet shtetërore për zhvillimin e lirë të kombit shqiptar dhe veçanërisht të mos lejohej asnjë lloj ndërhyrjeje në mënyrën e mësimit të gjuhës kombëtare (shqipe), duke ua lënë të drejtën e zgjedhjes së alfabetit të shqipes, siç qe vendosur në Kongresin e Dibrës, mësuesve (shqiptarë); të caktohej nga qeveria një subvencion për shkollat e të krishterëve shqiptarë, për t'i shkëputur ato nga ndikimi i Greqisë dhe t'i kërkohej Patrikanës nga qeveria që të lejonte përdorimin e gjuhës shqipe gjatë predikimit në kisha. Promemorja ngarkonte klubin qendror shqiptar që të këshillohej me Shejhylislamin rreth "dëmit" që gjoja i shkaktohej fesë myslimane nga përdorimi i alfabetit latin për mësimin e shqipes.

Kongresi mori masa edhe për forcimin e lidhjeve organizative ndërmjet klubeve shqiptare dhe për bashkërendimin e veprimtarisë së tyre. U vendos që klubet shqiptare të kishin një rregullore të njëjtë dhe të detyrueshme për të gjithë. Kjo rregullore a kanonizëm e

përgjithshme do të njihej zyrtarisht edhe prej qeverisë turke. Një vendim i tillë ishte marrë edhe në Kongresin e Elbasanit, por nuk ishte vënë në zbatim. Të gjitha klubet do të drejtoheshin nga klubi qendror shqiptar, atributet e të cilit tani, ndryshe nga vendimet që ishin marrë në kongreset e mëparshme, do t'i kishte klubi i Stambollit. Kongresi mendoi se duke e shpërngulur qendrën udhëheqëse të klubeve nga Manastiri në Stamboll do të krijohej një udhëheqje e vetme e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, ku të bashkoheshin drejtuesit e klubeve dhe deputetët atdhetarë shqiptarë të parlamentit, si Ismail Qemali, Hasan Prishtina, Shahin Kolonja etj. Këta deputetë parashikohej të përfshiheshin edhe në kryesinë qendrore të klubit të Stambollit.

Megjithatë, vendimi i Kongresit të Dytë të Manastirit, për të caktuar si klub qendror atë të Stambollit, nuk u pëlqye nga rrethet e gjera atdhetare të vendit. Edhe ngjarjet e mëvonshme, sidomos qëndrimi i udhëheqjes së këtij klubi ndaj kryengritjes shqiptare të vitit 1910, kur ajo mori hapur në mbrojtje xhonturqit, provuan se ky vendim ishte i gabuar. Po kështu u vendos që të thirrej në korrik të vitit 1910 një kongres më i gjerë në Janinë, i cili, krahas problemeve të tjera, do të zgjidhte përfundimisht problemin e alfabetit, duke zgjedhur njërën prej dy abëcëve latine, të miratuara nga Kongresi i Parë i Manastirit.

Në Kongresin e Dytë të Manastirit, ashtu si në ato të mëparshmet, u mbajtën edhe mbledhje të fshehta, në të cilat u diskutuan çështje të tilla politike, siç ishin forcimi i komiteteve të fshehta dhe masat që duheshin marrë për

përgatitjen e një kryengritjeje të përgjithshme. Por, ndërsa për komitetet e fshehta u mor vendim që të zgjeroheshin e forcoheshin më tej, për përgatitjen e kryengritjes së përgjithshme nuk u mor ndonjë masë. Kjo çështje u la të diskutohej e të vendosej në kongresin e ardhshëm. Sipas të dhënave të bashkëkohësve, në mbledhjet e fshehta u hartua edhe një program politik, të cilin ata e quanin platformë "të autonomisë së Shqipërisë", ku, përveç të tjerave, parashikohej njohja zyrtare e kombit shqiptar, mësimi i gjuhës shqipe në të gjitha shkollat e Shqipërisë dhe njohja e saj si gjuhë zyrtare. Megjithatë, ky program nuk u përfshi në asnjërin nga dy aktet e shpallura botërisht të Kongresit.
Kongresi i Dytë i Manastirit, ashtu si mitingjet, protestat dhe manifestimet e tjera që u zhvilluan në Shqipëri në pragun e këtij kuvendi, në shkurt-mars të vitit 1910, shprehën vendosmërinë e shqiptarëve për mbrojtjen e shkrimit shqip, të shkollës dhe të kulturës kombëtare në tërërsi. Ato ishin, njëherazi, një paralajmërim për kryengritjen e armatosur që do të shpërthente në pranverën e vitit 1910.

Reaksioni xhonturk dhe qëndresa kundër tij (1909-1910)

Megjithëse Komiteti Qendror "Bashkim e Përparim" kishte deklaruar se nuk do të përzihej në çështjen e zgjedhjes së alfabetit të gjuhës shqipe, në të vërtetë ai

mobilizoi kundër Lëvizjes Kombëtare Shqiptare dhe në mënyrë të veçantë kundër klubeve e shkollave shqipe gjithë administratën shtetërore, qendrore e lokale, klerikët fanatikë myslimanë dhe ekspeditat e gjeneralëve osmanë. Xhonturqit u mbështetën në këtë veprimtari në ligjin mbi "Bandat", që parashikonte masa shumë të rrepta për të gjithë ata që merrnin pjesë në çetat e armatosura dhe për të afërmit e tyre, si dhe në ligjin "Mbi shoqëritë", që ndalonte të gjitha organizatat kombëtare, përveç atyre osmane. Këto dy ligje u miratuan nga parlamenti turk në vjeshtën e vitit 1909, me gjithë kundërshtimin e deputetëve të kombësive joturke.

Në shtator të vitit 1909 me urdhër të valiut të Kosovës u mbyll shkolla shqipe e Pejës, ndërsa në janar u dëmtua dhe më pas u mbyll shkolla shqipe e Gjilanit. Në shkurt të vitit 1910 valiu i Kosovës urdhëroi të mbyllen të gjitha shkollat shqipe të këtij vilajeti dhe të hiqej mësimi i gjuhës shqipe nga shkollat shtetërore turke. Hasan Prishtina, Nexhip Draga e atdhetarë të tjerë kosovarë protestuan menjëherë kundër këtyre veprimeve dhe kërkuan nga Stambolli largimin e valiut nga Kosova. Veprime të njëjta kundër shkollave shqipe u ndërmorën në vilajetin e Janinës, ku drejtoria e arsimit në fillim kundërshtoi kërkesat për hapjen e shkollave të reja shqipe (në Leskovik, Filat etj.), ndërsa në mars të vitit 1910 urdhëroi të ndalohej mësimi i gjuhëve të tjera në shkolla, përveç turqishtes.

Në fillim të vitit 1910 ministri i Arsimit deklaroi se "qeveria turke do të qëndrojë neutrale në punët e alfabetit, por në shkollat shtetërore do të vërë në zbatim

alfabetin arab". Pas kësaj administrata osmane filloi të fuste me forcë në të gjitha shkollat e vendit alfabetin arab për mësimin e shqipes. Sikurse theksonte ato ditë kryeministri turk, Ibrahim Haki pasha, qeveria e Stambollit e trajtonte çështjen e alfabetit shqip si një problem politik, shihte në përdorimin e alfabetit latin për shkrimin e shqipes hapin e parë për shkëputjen e Shqipërisë nga Turqia. Në përpjekjet e tyre për të penguar përhapjen e shkollës e të shkrimit shqip xhonturqit u mbështetën te klerikët konservatorë dhe tek elementët e tjerë turkomanë nga radhët e shqiptarëve. Kjo i dha mundësi Komitetit Qendror "Bashkim e Përparim" ta paraqiste konfliktin rreth alfabetit shqip si një çështje të brendshme të shqiptarëve.

Myftiu i Manastirit, Rexhep Nuredini, që ishte autor i njërës prej tri abetareve shqipe me shkronja arabe, bënte propagandë kundër alfabetit shqip të Kongresit të Manastirit në vise të ndryshme të Shqipërisë së Mesme dhe të Jugut (deri në Vlorë), duke mobilizuar për këtë qëllim edhe klubet xhonturke të oficerëve. Po kështu vepronin myftinjtë e Korçës, të Gjirokastrës, të Kavajës etj., ndërsa ai i Prishtinës dhe i Dibrës nxorën qarkore, në të cilat u bënin thirrje gjithë klerikëve myslimanë të organizonin mitingje për të përkrahur alfabetin arab.

Të nxitur nga xhonturqit, një grup prej 14 deputetësh të parlamentit, që u paraqitën si shprehës "të ndjenjave të popullit shqiptar", edhe pse mjaft prej tyre nuk dinin të shkruanin e të lexonin shqip, kërkuan nga kryeministri turk në janar të vitit 1910 që të përdorej alfabeti arab për shkrimin e shqipes dhe të ndalohej ai latin. Kishte midis

tyre edhe deputetë shqiptarë të njohur për qëndrimet e tyre antikombëtare, si Mahmut Bedriu (Peja), Haxhi Ali Elbasani, Fuat Pasha i Prishtinës, Sait Efendiu (Idrizi) i Shkupit, Hasan Basriu i Dibrës, Riza Efendiu i Shkodrës etj.

Përkundrazi, deputetët atdhetarë, Ismail Qemali, Hasan Prishtina, Nexhip Draga, Shahin Kolonja etj., të zemëruar nga veprimet e parlamentarëve turkomanë, i dërguan kryeministrit një letër proteste, ku kërkuan që të respektoheshin të drejtat e ligjshme të shqiptarëve, të liheshin ata të lirë të përdornin alfabetin që dëshironin dhe që administrata qeveritare të mos ndërhynte.

Në bashkëpunim me elementët turkomanë, si Sait Efendiu (deputet i Shkupit), Arif Hiqmeti etj., valiu i Kosovës, Masar Beu, më 2 shkurt të vitit 1910 organizoi një miting në një nga xhamitë e Shkupit, në të cilën klerikët fanatikë i shpallën shkronjat latine në kundërshtim me fenë islame dhe kërkuan që të ndalohej përdorimi i tyre për gjuhën shqipe. Më 6 shkurt u mbajt një miting tjetër në një nga xhamitë e Manastirit, ku u kërkua të hiqej alfabeti latin për gjuhën shqipe dhe të futej ai arab, me të cilin ishin shkruar edhe librat e shenjtë.

Mitingje të tilla në përkrahje të alfabetit arab u mbajtën në shkurt të atij viti edhe në Elbasan, në Gjakovë, në Korçë, në Gjilan, në Vuçiternë, në Mitrovicë e në qendra të tjera, në të cilat, sipas dëshmive të bashkëkohësve, morën pjesë vetëm klerikët konservatorë myslimanë dhe një grusht fanatikësh turkomanë.

Disa nga krerët turkomanë shqiptarë, duke pasur përkrahjen e xhonturqve, formuan në Stamboll më 4 mars 1910 shoqërinë me emrin "Rrethi arsimor shqiptar" ("Arnavud mahfel mearifi"), të kryesuar nga kleriku e senatori Haxhi Ali Elbasani, që ishte edhe deputet i parlamentit, Mahmut Bedriu, deputet i Pejës etj. Shoqëria ose "Mahfeli", siç u quajt në atë kohë, filloi të punonte për të përhapur në Shqipëri arsimin me shkronja arabe, duke botuar libra e gazeta me këtë alfabet, që të forconte kështu "lidhjet e shqiptarëve me atdheun osman".

Me gjithë përpjekjet e xhonturqve për ta shtrirë veprimtarinë e "Mahfelit" në vilajetin e Kosovës e në viset e tjera shqiptare, ajo u kufizua kryesisht në Stamboll. Edhe këtu iu kundërvunë atij shumë atdhetarë të Stambollit, që formuan "Shoqatën e intelektualëve shqiptarë", e cila mbronte alfabetin shqip të Kongresit të Manastirit. I nxitur nga Komiteti "Bashkim e Përparim", edhe Shejhylislami i propozoi Ministrisë së Arsimit që të ndalonte futjen e alfabetit latin për shkrimin e shqipes dhe më 5 prill, me anën e një qarkoreje të veçantë u kërkoi të njëjtën gjë gjithë myftinjve të Shqipërisë. Shejhylislami dhe fill pas tij shehlerët e hoxhallarët fanatikë e turkomanë mallkuan alfabetin latin, u ndaluan myslimanëve ta përdornin atë dhe kërkuan prej tyre të shkruanin gjuhën shqipe vetëm me shkronjat "e shenjta" të Kuranit.

Në luftën kundër shkollës e kulturës kombëtare shqiptare turqit e rinj patën përkrahjen e dhespotëve ortodoksë grekë dhe të klerikëve grekomanë shqiptarë, të cilët, me ndihmën e bandave të andartëve që vepronin

lirisht edhe pas shpalljes së kushtetutës, terrorizonin popullsinë e Negovanit, të Bellkamenit dhe të fshatrave të Shqipërisë së Jugut e të Mesme, që kërkonte çeljen e shkollave shqipe.
Këto veprime të xhonturqve shkaktuan zemërim të thellë tek atdhetarët dhe te populli shqiptar, që u ngritën për mbrojtjen e shkollës e të shkrimit shqip dhe të të drejtave kombëtare. Në krye të kësaj qëndrese, thuajse të përgjithshme, u vunë klubet e shoqëritë atdhetare, si klubi "Bashkimi" i Manastirit, klubi "Dituria" i Gjirokastrës, klubet e Korçës, të Elbasanit, të Pogradecit, të Kolonjës etj. Ato protestuan pranë qeverisë turke kundër ndjekjeve që po u bëheshin gjuhës shqipe dhe atdhetarëve shqiptarë.
Paria e Prishtinës, në një letër që i dërgonte në fund të dhjetorit të vitit 1909 deputetit të saj, Hasan Prishtina, në emër të popullsisë së kësaj treve, protestonte kundër përpjekjeve që po bëheshin për t'i detyruar shqiptarët të përdornin alfabetin arab, theksonte se alfabeti latin është më i përshtatshëm për gjuhën shqipe, se përdorimi i tij nuk krijon ndonjë shqetësim as nga pikëpamja politike, as edhe nga ajo fetare. Në këtë dokument i kërkohej Hasan Prishtinës që të ndërmjetësonte pranë qeverisë që mësimet në shkollat fillore të bëheshin në gjuhën shqipe dhe që ajo të jepej me alfabetin latin.
Orvatjet e qeverisë turke në fillim të vitit 1910 për të futur në shkolla alfabetin arab për mësimin e shqipes, hasën në qëndresën e vendosur të mësuesve dhe të nxënësve, që në shumë qytete të Shqipërisë, si në Korçë, Berat, Durrës, Janinë, Shkup e në vende të tjera, braktisën

shkollat turke dhe protestuan kundër autoriteteve shtetërore. Edhe populli i Elbasanit iu përgjigj mitingut të klerikëve fanatikë e turkomanë myslimanë me një manifestim masiv kundër futjes së alfabetit arab, i cili u organizua më 18 shkurt 1910 në një nga sheshet e qytetit, ku morën pjesë rreth 7 000 qytetarë e fshatarë të ardhur nga Shpati dhe nga katundet e tjera të Elbasanit. Në këtë miting populli kërkoi nga qeveria dhe nga parlamenti të pranonin përdorimin e alfabetit shqiptar (latin) për shkrimin e gjuhës shqipe.

Më 27 shkurt u organizua nga klubi "Dituria" një miting i madh në Korçë në mbrojtje të abëcësë shqipe, ku morën pjesë rreth 15 000 veta nga qyteti e nga rrethi i Korçës, nga Devolli, nga Kolonja, nga Opari e nga Pogradeci. Në emër të popullit të mbledhur në këtë tubim iu dërguan telegrame proteste, kundër futjes së alfabetit arab, qeverisë turke dhe deputetëve shqiptarë të parlamentit.

Një pjesëmarrje të gjerë pati edhe mitingu që u zhvillua në Berat më 28 shkurt, ku qenë të pranishëm rreth 15 000 veta, banorë të qytetit e të fshatrave të rrethit. Në telegramet e protestës, që iu dërguan qeverisë turke në emër të popullit të Beratit, theksohej se, duke futur alfabetin arab "qeveria synon t'i lërë shqiptarët në padije si gjer më sot dhe të futë grindje e përçarje ndërmjet atyre myslimanë dhe ortodoksë". Mitingje të tilla u mbajtën edhe në Tepelenë, në Përmet dhe në Skrapar. Telegrame proteste kundër përdorimit të alfabetit arab dhe për mbrojtjen e alfabetit latin iu dërguan qeverisë e parlamentit turk edhe në emër të popullit të Gjirokastrës (nga Shoqëria "Bashkimi"), të Çamërisë (nga klubi i

Filatit), të Shkupit, të Ohrit, të Vlorës, të Prishtinës, të Mitrovicës, të Gramshit, të Përmetit, të Frashërit, të Tepelenës, të Konicës, të Leskovikut etj.
Duke vënë theksin në përmasat e kësaj lëvizjeje, konsulli francez në Shkodër i shkruante qeverisë së tij, në shkurt të vitit 1910, se tërë Shqipëria është ngritur kundër përpjekjeve të qeverisë turke për t'i detyruar shqiptarët të përdorin alfabetin arab, si dhe për të mbrojtur alfabetin shqip të vendosur në Kongresin e Manastirit. Mitingjet e zhvilluara nga klubet shqiptare në shkurt të vitit 1910, si nga shkalla e organizimit e rregulli që zotëroi në to, nga përmbajtja kombëtare e përparimtare e kërkesave të tyre, ashtu edhe nga përmasat që morën, ishin ngjarje të reja për Lëvizjen Kombëtare Shqiptare dhe të rralla e të papara deri atëherë, jo vetëm për Shqipërinë, por edhe për gjithë Perandorinë Osmane.

Kongresi Kombëtar i Elbasanit (2-8 shtator 1909)

Kongresi i Dibrës nuk e ndryshoi vendimin e marrë qysh më parë nga rrethet atdhetare për të mbledhur një kongres kombëtar në Elbasan, i cili do të shqyrtonte në mënyrë të veçantë problemin e shkollës shqipe që ishte bërë objekt i sulmeve të xhonturqve, përgatitjen e mësuesve, organizimin në shkallë kombëtare të rrjetit të shkollave shqipe, drejtimin e përqendruar të tyre nga një institucion kombëtar dhe sigurimin e mjeteve financiare për mbajtjen e tyre. Thirrja e tij bëhej e domosdoshme

edhe për shkak të rritjes së rrjetit të shkollave shqipe pas Kongresit të Manastirit.
Pak kohë para thirrjes së Kongresit (më 3 korrik 1909), Ministria e Arsimit e Turqisë, nën trysninë e kërkesave këmbëngulëse të shqiptarëve, u detyrua të njoftonte vilajetet që të përfshinin në programin mësimor të shkollave shtetërore, qytetëse (ruzhdie) dhe në gjimnazet (idadie), mësimin e gjuhës së vendit (shqipe) dhe që mësuesit e kësaj gjuhe të paguheshin nga buxheti i shtetit. Kjo ishte një rethanë që favorizonte punimet e Kongresit të Elbasanit për çështjet e arsimit shqiptar.
Kongresi u thirr me nismën e klubit shqiptar të Selanikut, i cili, qysh në fund të marsit njoftoi për këtë klubet e shoqëritë shqiptare, ndërsa me përgatitjen e tij të drejtpërdrejtë u morën klubet "Bashkimi" e "Vllaznia" të Elbasanit, që u shpërndanë ftesat klubeve dhe shoqërive shqiptare brenda e jashtë vendit.
Kongresi i Elbasanit u hap më 2 shtator të vitit 1908 dhe i vijoi punimet deri më 8 shtator. Në të morën pjesë 35 delegatë, përfaqësues të klubeve dhe të shoqërive shqiptare të qyteteve të tilla të Shqipërisë, si Tirana, Durrësi, Dibra, Shkupi, Manastiri, Gjirokastra, Korça, Berati, Leskoviku, Përmeti, Ohri, Struga, Pogradeci, Janina, Filati, krahinat e Gramshit, të Skraparit etj. Nuk mundën të dërgonin delegatët e tyre Vlora, për shkak të terrorit të xhonturqve mbi atdhetarët e këtij qyteti, Shkodra, për arsye të veprimtarisë së reaksionit xhonturk, të përkrahur nga klerikët konservatorë dhe elementët fanatikë turkomanë, si edhe vilajeti i Kosovës, po për shkak të pengesave që nxorën klerikët dhe paria

konservatore e fanatike, që përkrahte alfabetin arab. Megjithatë, klubi i Shkupit ngarkoi si përfaqësues të vetin Mithat Frashërin, ndërsa atdhetarët shkodranë njoftuan në mënyrë paraprake se do t'i njihnin vendimet e këtij Kongresi. Po ashtu nuk u përfaqësuan edhe shoqëritë atdhetare të mërgimit.

Midis delegatëve të Kongresit kishte veprimtarë të njohur të lëvizjes kombëtare, si edhe mësues atdhetarë, siç ishin Orhan Pojani, Grigor Cilka, Gjergj e Sevasti Qiriazi, Mithat Frashëri, Dervish bej Biçaku, Ahmet Dakli, Refik Toptani, Hafiz Ibrahim Dalliu, Thoma Papapano, Hamdi Ohri, Nikollë Kaçori, Josif Haxhi Mima, Simon Shuteriqi, Dhimitër Buda, Abdullah Rushit Ahmeti (Struga), Abdulla Koprëncka, Kristo Dako, Emin Haxhi Ademi, Selman Blloshmi, Andrea Konomi, Idhomenë Kosturi etj.

Punimet e Kongresit u drejtuan nga një kryesi e zgjedhur nga delegatët dhe e përbërë nga Dervish bej Biçaku (kryetar), Mithat Frashëri (nënkryetar) dhe Simon Shuteriqi e Josif Haxhi Mima (sekretarë). Ashtu siç ishte parashikuar, në Kongres u shqyrtuan tri çështje themelore: çelja e një shkolle normale dhe masat e nevojshme për të; krijimi i një qendre të vetme për drejtimin, për organizimin dhe për financimin e shkollave shqipe; masat për bashkërendimin e veprimtarisë së klubeve shqiptare.

Akti themelor i Kongresit të Elbasanit ishin Vendimet ose, siç u quajt ndryshe, Rezoluta prej 15 nenesh, që u miratua dhe u nënshkrua nga gjithë delegatët. Një nga masat më të rëndësishme të kësaj Rezolute ishte çelja në

Elbasan në vjeshtën e atij viti e një Shkolle Normale (pedagogjike), me gjashtë klasa, e cila do të përgatiste mësues për shkollat fillore shqipe. Shkolla pedagogjike do të mbahej me kontributin e të gjitha klubeve dhe shoqërive shqiptare. Në Kongres u miratua edhe një rregullore e veçantë e Shkollës Normale, e përpunuar nga një komision i posaçëm. Për t'i vënë shkollat shqipe nën një drejtim unik e të përqendruar në shkallë kombëtare, Kongresi vendosi që të krijohej në Korçë Shoqëria qendrore shkollore "Përparimi".
Sipas statutit të saj të veçantë ajo do të quhej Shoqëria e mësonjëtoreve shqipe "Përparimi" dhe do të kishte për detyrë të kujdesej për mbajtjen e administrimin e Shkollës Normale të Elbasanit, për hapjen e shkollave të tjera shqipe dhe për botimin e librave të nevojshëm. Pranë shoqërisë krijohej edhe një arkë e përgjithshme, që do të plotësohej me kontributin e klubeve, të shoqërive dhe të atdhetarëve të veçantë. Me qëllim që Shoqëria "Përparimi" të ushtronte lirisht dhe pa pengesa veprimtarinë e saj, Kongresi kërkoi që ajo të njihej zyrtarisht si "person juridik" nga qeveria turke; u hartua një rregullore e veçantë e kësaj shoqërie, e cila do t'i paraqitej gjithashtu për miratim qeverisë. Shoqëria duhej të kërkonte ndihmën financiare të shtetit turk.
Kongresi ngarkoi "të gjitha klubet dhe shoqëritë, si edhe çdo shqiptar, të përpiqeshin të vinin gjuhën shqipe në të gjitha shkollat e vendit". Në mënyrë të veçantë u ngarkua klubi qendror (i Manastirit) që të "nxirrte lejen që gjuha shqipe të hynte zyrtarisht në të gjitha shkollat e Shqipërisë", ndërsa me pikën 8 të Vendimeve, Kongresi i

Elbasanit ngarkonte klubin qendror që sa më parë të "kërkonte futjen e gjuhës shqipe si gjuhë mësimi në të gjitha shkollat shtetërore fillore dhe qytetëse (ruzhdie)". Përmbushja e këtyre kërkesave do të shënonte një hap të rëndësishëm në shndërrimin e të gjitha shkollave të huaja (turke ose në gjuhë të tjera) në shkolla shqipe dhe për themelimin e një sistemi kombëtar shkollor në Shqipëri. Kongresi ngarkonte gjithë atdhetarët shqiptarë që të kërkonin nga këshillat e vilajeteve hapjen e shkollave bujqësore, aq të nevojshme për popullsinë e zonave bujqësore të vendit.

Në Kongres u diskutuan gjithashtu disa çështje organizative dhe politike. Për të forcuar bashkëpunimin, lidhjet organizative dhe bashkërendimin e veprimeve ndërmjet të gjitha klubeve e shoqërive, u vendos që të gjitha klubet e shoqëritë shqiptare të drejtoheshin nga një klub qendror. Në pajtim me këtë Kongresi zgjodhi si klub qendror (për dy vjet) klubin e Manastirit, i cili qëndronte në krye të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare. Për të bashkërenduar dhe për të organizuar më mirë e në përmasa kombëtare veprimtarinë politiko-kulturore të klubeve dhe të shoqërive shqiptare, u miratua një Rregullore e përgjithshme e klubeve dhe e shoqërive shqiptare, ku përcaktoheshin detyrat e tyre dhe format e lidhjeve e të bashkëpunimit ndërmjet tyre.

Në mbledhjet e mbyllura e të shpeshta në Kongres delegatët shprehën mosbesimin ndaj regjimit xhonturk dhe Komitetit Qendror "Bashkim e Përparim", të cilët në shumë qytete të Shqipërisë, si në Strugë, në Tiranë, në Gjirokastër, në Filat etj., nxitnin komitetet lokale që t'u

kundërviheshin aspiratave kombëtare të shqiptarëve. Në emër të delegatëve të Kongresit iu dërgua kryeministrit turk një telegram, në të cilin protestohej kundër dhunës mbi atdhetarët shqiptarë në Vlorë e në qendra të tjera dhe kërkohej lirimi i bejlerëve atdhetarë të arrestuar. Po në këto mbledhje delegatët u shprehën për një organizim më të mirë të komiteteve të fshehta dhe për forcimin e lidhjeve ndërmjet tyre.

Në Kongres u shfaq mendimi se, në kushtet kur xhonturqit nuk pranonin t'i njihnin popullit shqiptar të drejtat më elementare kombëtare e njerëzore për t'u çliruar njëherë e përgjithmonë nga arbitrariteti e zgjedha e turqve të rinj, shqiptarët duhej të organizonin luftën e armatosur për të siguruar autonominë e Shqipërisë dhe për këtë qëllim populli shqiptar duhej të bashkëpunonte me popujt e tjerë të shtypur të Turqisë Evropiane, me maqedonët, vllehët etj., që luftonin gjithashtu për çlirimin e tyre kombëtar.

Kongresi dënoi ndërhyrjet e fuqive të huaja në Shqipëri që ishin forcuar në fillim të shek. XX, e veçanërisht pas aneksimit të Bosnjës dhe të Hercegovinës nga Austro-Hungaria. Në këtë Kongres u vendos gjithashtu që pas tri vjetësh, më 1912, të mbahej po në Elbasan një kuvend tjetër, që do të shqyrtonte "nevojat e Shqipërisë", programin e të cilit do ta përgatisnin shoqëritë e këtij qyteti.

Kongresi i Elbasanit i dha një shtytje të re lëvizjes për shkollën dhe për arsimin kombëtar në përgjithësi. Të mbështetur në vendimet e tij, atdhetarët shqiptarë ngritën në Korçë, më 20 shtator 1909, Shoqërinë qendrore

shkollore “Përparimi”, në kryesinë e së cilës u zgjodhën atdhetarët e njohur Orhan Pojani (kryetar), Stavri Karoli, Idhomenë Kosturi e Mihal Gramenoja.
Me qëllim që Shoqëria “Përparimi” të ushtronte ligjërisht të gjitha kompetencat e saj si një institucion qendror e drejtues i arsimit kombëtar, kryetari i saj Orhan Pojani, duke pasur mbështetjen e deputetëve atdhetarë shqiptarë të parlamentit, bëri përçapje pranë Këshillit të Shtetit në Stamboll për të siguruar njohjen e saj zyrtare si person juridik. Megjithëse kjo kërkesë u kundërshtua nga qeveria turke, Shoqëria “Përparimi” u kthye në të vërtetë në një organizatë arsimore kombëtare dhe dha një ndihmë të çmuar për organizimin e drejtimin e arsimit shqiptar. Ajo dha një ndihmesë të veçantë për sigurimin e fondeve të nevojshme financiare për Shkollën Normale të Elbasanit dhe për shkollat e tjera shqipe. Duke iu përgjigjur thirrjes që shpërndau për këtë qëllim brenda e jashtë Shqipërisë, dhjetëra klube dhe shoqëri atdhetare të vendit, organet e shtypit shqiptar, shoqëritë e kolonive të mërgimit dhe qindra atdhetarë derdhën në arkën e saj shuma të mëdha të hollash. Brenda një kohe të shkurtër u mblodhën për nevojat e Shkollës Normale dhe të shkollave të tjera 1 000 lira turke. Në mënyrë të veçantë rreth 340 atdhetarë dhanë ndihmën e tyre në të holla.
Më 1 dhjetor 1909 u çel në Elbasan Shkolla Normale (pedagogjike), që ishte shkolla e parë e mesme kombëtare shqipe. Mësuesit e saj të parë ishin atdhetarë të njohur dhe njerëz të shquar në lëmin e kulturës, si Aleksandër Xhuvani (i diplomuar në Greqi për filologji, i dalluar në fushën e letërsisë), Sotir Peci (i diplomuar gjithashtu në

Greqi për matematikë-fizikë, drejtor i gazetës "Kombi") etj. Drejtor i parë i saj u caktua Luigj Gurakuqi?, i cili vuri të gjitha forcat dhe aftësitë e tij në shërbim të arsimit kombëtar. Në Shkollën Normale jepnin gjithashtu mësim Petër Dodbiba, Simon Shuteriqi, Hasan Mejza dhe Hafiz Ibrahim Dalliu.

Shkolla Normale kishte gjashtë klasa, me një plan mësimor prej 30 lëndësh, humanitare, të shkencave të natyrës etj. Ajo dallohej për karakterin e saj kombëtar, që përcaktohej nga përmbajtja e lëndëve dhe nga fakti se pranonte nxënës të të gjitha besimeve fetare, myslimanë e të krishterë. Atdhetarët bashkëkohës e çmonin atë si një vatër të formimit atdhetar të brezit të ri.

Qysh në vitin e parë të themelimit të saj (1909-1910) Shkolla Normale e Elbasanit pati 160 nxënës të ardhur nga të gjitha anët e Shqipërisë. Disa prej tyre, rreth 50 nxënës, kishin ardhur nga Kosova, Rrafshi i Dukagjinit e Dibra, të dërguar nga klubet shqiptare, si ai i Shkupit, i Dibrës etj. dhe me kujdesin e veçantë të atdhetarëve Hasan Prishtina, Bajram Curri, Nexhip Draga etj.

Shkolla shqipe u hapën në këtë periudhë pas Kongresit të Elbasanit edhe në vende të tjera të Shqipërisë. Në fund të shtatorit u bë në Korçë përurimi i shkollës së riorganizuar të djemve (i mësonjëtores së parë shqipe të vitit 1887), çelur qysh në pranverën e vitit 1909, e cila ishte një nga shkollat më të plota me pesë klasa dhe pesë mësues. Në tetor u hapën shkolla shqipe në Progër, në Cukaj të Martaneshit, në Verlen të Bilishtit, në Margëllëç, ndërsa në muajin dhjetor u çel shkolla shqipe në

Negovan (nën drejtimin e Petro Nini Luarasit) dhe në fshatin Koshtan të Tepelenës.
Me përpjekjet e Klubit Arsimor të Shkupit, të Hasan Prishtinës e të atdhetarëve të tjerë kosovarë, në vjeshtën e vitit 1909 u hapën shkolla shqipe në vilajetin e Kosovës, në Moravë, në Gjilan dhe në fshatin Pozharan, ku mësonin edhe fëmijët e katundeve përreth. Shkolla shqipe kanë qenë ngritur në këtë kohë edhe në Prizren, në Gjakovë, në Pejë dhe në Vuçiternë. Në janar të vitit 1910 klubi i Shkupit ngriti një shkollë private shqipe në këtë qytet, ndërsa në shkurt u hap shkolla shqipe në Mitrovicë.
Në mars-prill të vitit 1910 u çelën shkolla shqipe në Mesare të Leskovikut, në Labovën e Poshtme (nga klubi "Drita" i Gjirokastrës), në fshatra të Çamërisë, si në Ninat, Konispol, Koskë, Janjar, Konicë, Mazarek etj. Në verën e atij viti u hapën shkolla shqipe në Tepelenë, në Tiranë, në Vlorë, në Zerqan, në Kaninë, në Leskovik etj. U bënë përçapje për ngritjen e shkollave të tjera shqipe pothuajse në të gjitha qytetet e Shqipërisë. Në fillim të vitit 1910 klubi i Dibrës mori nismën për hapjen e një numri të madh shkollash shqipe në këtë rreth.
Gjatë vitit shkollor 1909-1910, përveç qyteteve të tjera, gjuha shqipe u fut edhe në gjimnazet turke të Elbasanit, të Vlorës, të Beratit dhe të Shkupit (ku jepte mësim Bedri Pejani). Shqipja filloi të mësohej gjithashtu në shkollën "Edep" të Shkupit, që mbahej nga klubi "Rinia patriotike" ("Shubani vatan") të këtij qyteti. Sipas të dhënave të shtypit shqiptar të kohës, në vjeshtën e vitit 1909 gjuha shqipe ishte futur si lëndë pothuajse në të

gjitha gjimnazet (idadijet) turke të Shqipërisë dhe në shumë shkolla qytetëse (ruzhdie). Meqë Ministria e Arsimit, qysh në korrikun e vitit 1909, kishte lejuar mësimin e gjuhëve të vendit në gjimnazet turke, mësuesit e gjuhës shqipe në këto shkolla u emëruan nga organet e saj.

Por këto shkolla ndiqeshin nga një numër i kufizuar nxënësish, prandaj atdhetarët shqiptarë vijuan të kërkonin që gjuha shqipe të mësohej në të gjitha shkollat fillore të vendit, rrjeti i të cilave ishte më i gjerë. Në fundin e vitit shkollor 1909-1910 mësimi i shqipes u fut edhe në shkollën qytetëse të Prevezës, në atë të Lurosit, në shkollat fillore turke të Kolonjës, të Oparit, të Devollit, të Përmetit, të Elbasanit dhe të disa qendrave të Kosovës. Në fillim të vitit 1910 përfaqësues të popullsisë së Ohrit kërkuan nga parlamenti që gjuha shqipe të mësohej në të gjitha shkollat shtetërore të kësaj prefekture.

Me gjithë pengesat e shovinistëve grekë, atdhetarët shqiptarë gjatë vitit 1910 arritën të fusnin mësimin e shqipes edhe në shkollat e tjera greke, si në ato të Elbasanit, të Beratit, të Kavajës dhe të Labovës së Poshtme. Por përhapja e mëtejshme e shkollave dhe e shkrimit shqip u pengua për shkak të shpërthimit të reaksionit xhonturk kundër kulturës dhe Lëvizjes Kombëtare Shqiptare në përgjithësi. */Shqipëria.com/*

(Përgatiti për publikim moderatori i pashtriku.org)